



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 6.6.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9220, DATË 19.5.2008, “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 5.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.9220, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Antoneta Dhima.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent Znj. Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, dhe 155 të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, objektivat dhe efektet e synuar të propozimit, problematikat e konstatuara dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit:

Bazuar në raportin e vlerësimit të Komitetit Moneyval, i Këshillit të Evropës, Shqipërisë i është lënë një vit kohë për përmbushjen e rekomandimeve dhe adresimin e problematikave të evidentuara. Raporti synon vlerësimin e përputhshmërisë të kuadrit ligjor e rregullator në vend për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me 40 rekomandimet e FATF-së, të cilat njihen si standard detyrues e unifikues në rang botëror për këto çështje.

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.9220, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ka si qëllim pikërisht adresimin e njërit prej rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Moneyval), të Këshillit të Evropës, lidhur me përdorimin e parasë fizike dhe reduktimin e ekonomisë informale nga personat fizikë/juridikë tregtarë.

Përmes këtij projektligji propozohet vendosja e detyrimit për të gjithë tatimpaguesit persona fizikë, subjekte të regjistrimit në TVSH, tatimpaguesit persona juridikë pavarësisht nga qarkullimi i realizuar si dhe organizatat jofitimprurëse e regjistruara sipas legjislationit në fuqi, për hapjen/pasjen e llogarive bankare dhe deklarimin e saj në organin tatimor.

Nga ky detyrim janë përjashtuar tatimpaguesit (personat fizikë) që nuk janë subjekt i detyrimit për t’u regjistruar për TVSH-në, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor më të vogël se 2 000 000 (dy milionë) lekë, kjo bazuar në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Projektligji përcakton gjithashtu edhe afate konkrete për hapjen e këtyre llogarive bankare si për tatimpaguesit e regjistruar tashme në QKR dhe për ato që do të regjistrohen rishtas.

Gjithashtu projektligji ka vendosur edhe sanksionimin e tatimpaguesve të cilët nuk do të përmbushin detyrimin për hapjen e kësaj llogarie.

Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji përbehet nga 3 nene gjithsej përmbajtja e të cilave konsiston përmbledhtazi si më poshtë vijon:

- Neni 1 i projektligjit, parashikon shtimin e një pike 1/2 në nenin 59, duke përcaktuar vendosjen e detyrimit për të gjithë tatimpaguesit persona fizikë, subjekte të regjistrimit në TVSH, tatimpaguesit persona juridikë pavarësisht nga qarkullimi i realizuar si dhe organizatat jofitimprurëse e regjistruara sipas legjislacionit në fuqi, për hapjen/pasjen e llogarive bankare dhe deklarimin e saj në organin tatimor.
- Neni 2 i projektligjit, shton disa paragrafë në nenin 120 shtohen disa paragrafë, duke parashikuar sanksionimin e tatimpaguesve të cilët nuk do të përmbushin detyrimin për hapjen e kësaj llogarie në përputhje me nenin 1 si më poshtë:
 - a) Tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me qarkullim deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
 - b) Tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, me qarkullim mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;
 - c) Organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Gjithashtu vendosen afate konkrete për hapjen e këtyre llogarive bankare si për tatimpaguesit e regjistruar tashme në QKR dhe për ato që do të regjistrohen rishtas.

- Neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se projektligji ka si qëllim adresimin e njërit prej rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Moneyval), të Këshillit të Evropës, lidhur me përdorimin e parasë fizike dhe reduktimin e ekonomisë informale. Për këtë qëllim në shtator 2018, Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave ka miratuar planin e veprimit, duke caktuar për çdo masë afate dhe institucione përgjegjëse.

Projektligji është pjesë e masave të këtij plani veprimi dhe vjen si një paketë me një sërë projektligjesh të tjerë në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Moneyval dhe mundëson vendosjen e detyrimit për tatimpaguesit qofshin këto persona fizikë subjekt të regjistrimit në TVSH apo persona juridikë dhe organizatat jofitimprurëse për hapjen/pasjen e llogarive bankare dhe deklarimin e saj në organin tatimor, afatet konkrete për hapjen e tyre si dhe përcakton penalitetet në rast të mosveprimit nga tatimpaguesit.

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, administrata tatimore, si dhe tatimpaguesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, theksuan rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të masave që Qeveria Shqiptare po ndërmerr lidhur me masat që duhet të ndërmarren vendi ynë në kundër të reduktimit të ekonomisë informale.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, anëtarët e komisionit shprehën shqetësimin lidhur me masën e penaliteteve të propozuara, të cilat rezultojnë të larta duke mos respektuar kështu parimin e efektivitetit dhe proporcionalitetit që ndiqet në përcaktimin e tyre. Njëzëri anëtarët e komisionit vlerësuar të nevojshme përgjysmimit të tyre.

V. Përfundime dhe ndryshimet e projektligjit

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar si tejet pozitive mundësinë që krijohet përmes këtij projektligji, për reduktimin e ekonomisë informale me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim nën për nën dhe në tërësi me ndryshimet e mëposhtme:

- Neni 1, i projektligjit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 1

Në nenin 59, pas pikës 1/1 shtohen pikat 1/2 dhe 1/3, me këtë përmbajtje:

“1/2. Tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor, janë të detyruar të kenë llogari bankare të biznesit/organizatës së regjistruar dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

1/3. Tatimpaguesit e regjistruar rishtas, janë të detyruar të hapin llogarinë bankare të biznesit/organizatës jo më vonë se 20 (njëzet) ditë kalendarike nga e nesërmja e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit/administratën tatimore dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.”

- Neni 2, i projektligjit, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 2

Në nenin 120 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në pikën 1/2 dhe 1/3 të nenit 59, të këtij ligji nga tatimpaguesit dënohen, si më poshtë vijon:

- a. Për tatimpaguesit, persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me qarkullim deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë në masën 25 000 lekë;

- b. Për tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, me qarkullim mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë në masën 50 000 lekë;
- c. Për organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 37 000 lekë.

Në rast të vazhdimit të mosrespektimit të detyrimit të pikës 1/2 dhe 1/3 të nenit 59 të këtij ligji edhe pas dënimit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të këtij paragrafi, tatimpaguesi dënohet me dyfishin e gjobës së parë.”

- Pas nenit 2 të projektligjit shtohet neni 3 me këtë përmbajtje:

Neni 3 **Dispozitë tranzitore**

Tatimpaguesit e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/administratës tatimore janë të detyruar të hapin llogarinë bankare, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

- Neni 3 i projektligjit bëhet neni 4.

RELATOR

KRYETAR

Antoneta DHIMA

Arben AHMETAJ